

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Athina mohon kërcënimin e ambasadores amerikane për rrëzimin e qeverisë greke
ADRESA	https://tpz.al/athina-mohon-kercenimin-e-ambasadores-amerikane-per-rrzezimin-e-qeverise-greke-i334102
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 19:45:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 19:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	89159bb74ca4ab55dec41040d5a19a8827e3e04b0b20306041798db956f052e0
TEKSTI	a284e502fa7d12b58ec8d8780f267e8d3f1385f8c788e4e9c3d4bdfefb3229178
PAMJA	7b3ee19d6942d1c455bacaf08a6496304198a0a42227d7d6fa02d0c75b4cfb39

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	00727816c478058b6913ee903b57a5e251873a9d02196dd9f934eb23024a1aa5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6a4afcd2fdba1fd2c3f5e26c1cb3946785567999c2c435268418bbbf9bbb6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/00727816c478058b6913ee903b57a5e251873a9d02196dd9f934eb23024a1aa5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BALLKAN, 28 SEPTEMBER 2026, 21:40

Athina mohon kërcënimin e ambasadores amerikane për rrëzimin e qeverisë greke

tpz.al TPZ



Qeveria greke ka mohuar raportimin e "Wall Street Journal" se ambasadorja e SHBA-së në Athinë, Kimberly Guilfoyle, ka kërcënuar me rrëzimin e qeverisë greke gjatë një darke me zyrtarë grekë dhe amerikanë.

Zëdhënësi i qeverisë greke, Pavlos Marinakis, tha se nuk është ngritur kurrë çështja e një kërcënimi ndaj qeverisë dhe se një veprim i tillë nuk do të tolerohej.

"Duhet të them dhe ta bëj të qartë se nuk ka pasur kurrë asnjë çështje që lidhet me një kërcënim ndaj qeverisë greke dhe, për të qenë seriozë, një gjë e tillë nuk do të tolerohej kurrë", deklaroi Marinakis.

Sipas "Wall Street Journal", incidenti i pretenduar ka ndodhur gjatë një darke në Athinë në muajin mars, ku Guilfoyle është përfshirë në një debat me ministrin grek të Energjisë, Stavros Papastavrou.

Sipas burimeve të cituara nga gazeta amerikane, gjatë bisedës për rënien e qeverisë së Rumanisë, ambasadorja amerikane dyshohet të ketë thënë: "Ne mund ta bëjmë këtë me çdo vend që duam. Mund ta bëjmë edhe këtu".

Papastavrou, sipas të njëjtit raportim, i është përgjigjur se Shtetet e Bashkuara nuk mund ta zëvendësonin qeverinë greke, e cila është zgjedhur nga qytetarët.

Avokati i Kimberly Guilfoyle ka kundërshtuar përshkrimin e bisedës të publikuar nga "Wall Street Journal". Ndërkohë, edhe qeveria greke ka mohuar se ka pasur ndonjë kërcënim ndaj saj.

Deklaratat e Marinakis erdhën në një kohë kur raportimi ka shkaktuar reagime edhe nga partitë opozitare greke, të cilat kanë kërkuar sqarime lidhur me takimin dhe pretendimet e publikuara.

Përveç çështjes politike, artikulli i "Wall Street Journal" lidhet edhe me përpjekjet e Guilfoyle për promovimin e gazit natyror të lëngshëm amerikan në Ballkan dhe rolin e Greqisë në

ide!

Ish-shefja e SHISH, nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqet e saj

Nga Lorenc Vangjeli

Rikthimi i SHISH-it në politikë si banalitët

Nga Mero Baze

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tiera video

transportimin e gazit amerikan drejt vendeve te Evropes Qendrore dhe Lindore.

Marinakis hodhi poshtë gjithashtu pretendimet për ekzistencën e ndonjë "shantazhi politik" lidhur me gazin amerikan, duke theksuar se marrëdhëniet mes Greqisë dhe SHBA-së janë strategjike dhe bazohen, sipas tij, në respektin e ndërsjellë dhe vlerat e përbashkëta.

BALLKAN / 28 September 2026, 18:20

SHBA rrit presionin ndaj NIS-it, dy kongresistë kërkojnë vazhdimin e sanksioneve ndaj kompanisë serbe

BALLKAN / 28 September 2026, 13:02

Dënohet Haga/ Deklarata e Kuvendit kundër burgosjes së ish-krerëve të UÇK, votë unanime e Kuvendit të Kosovës

BALLKAN / 27 September 2026, 22:31

Policia malazeze gjen një milion euro dhe pajisje IT në apartamentin e shtetasve rusë të arrestuar

BALLKAN / 27 September 2026, 20:57

Gazetari i CNN-it ia përplas Vuçiçit krimet e Serbisë: Kur Perëndimi mendon për ju, i kujtohen luftërat në Ballkan

BALLKAN / 27 September 2026, 20:38

Pas paralajmërimit, Aleksandar Vuçiç jep dorëheqjen si President i Serbisë

BALLKAN / 27 September 2026, 17:17

Kongresisti amerikan paralajmëron Evropën: Hiqeni partinë e Vuçiçit nga EPP para zgjedhjeve!

BALLKAN / 27 September 2026, 14:59

BALLKAN / 27 September 2026, 14:46

"Dosja 23" në Zubin Potok, 9 të arrestuarit për krime lufte ndalohen për 48 orë (VIDEO)

BALLKAN / 27 September 2026, 10:57

Dyshohen si vrasës të "Grupit të Intelektualëve", 9 në pranga në veriun e Kosovës për krime lufte

Dorëhiqet Vuçiç: Nder i madh të isha president, do t'i kujtoni këto vite

BALLKAN / 26 September 2026, 21:11

Hallka që përmbysi dënimin e Gotovinës, çfarë mund të vlejë në apelin e katër ish-krerëve të UÇK-së?

BALLKAN / 26 September 2026, 20:49

Serbia kërkon zgjatjen e marrëveshjes për gazin rus, Vuçiç pas telefonatës me Putinin: Do të sigurojmë furnizime të qëndrueshme

BALLKAN / 25 September 2026, 21:36

Mali i Zi ndalon mbi 24 tonë mish të skaduar të destinuar për Kosovë, AUV nis kontrollet

BALLKAN / 25 September 2026, 20:17

Protesta në disa qytete të Kosovës kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së, kërkohet ndryshimi i ligjit për Specialen

BALLKAN / 25 September 2026, 18:39

Kuvendi i Kosovës të hënën seancën e radhës plenare, në rend dite votimi për deklaratën për Gjykatën Speciale

BALLKAN / 25 September 2026, 11:18

BALLKAN / 25 September 2026, 09:18

[Negociatat me BE/ Mali i Zi vendos viza për shtetasit nga Rusia, Bjellorusia dhe Turqia](#)

[Serbi/ Vuçiç: Do të jap dorëheqjen të dielën, por do të flas me Putinin para përfundimit të mandatit](#)

BALLKAN / 24 September 2026, 21:38

[Hoxhaj: Kosova duhet ta dërgojë aktgjykimin e Speciales në Komisionin e Venecias](#)

BALLKAN / 24 September 2026, 18:51

[Arrestohet klani serb i drogës, zbulohet “dhoma e torturës”](#)

BALLKAN / 23 September 2026, 22:10

[“Jo në emrin tim”/ Mijëra qytetarë sërish protestë në mbështetje të ish krerëve të UÇK-së! Thirrje institucioneve të veprojnë](#)

BALLKAN / 23 September 2026, 20:32

[Vuçiç e promovoi takimin me Von der Leyen, reagon KE: Ishte i rastësishëm dhe i paparalajmëruar](#)

[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#) [NJOFTIME NGA TPZ.AL](#) 

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.



Built & Monetized by **Mediadesk**

AKTUALITET
IDE
NË FOKUS
BALLKAN
BOTA
LIFESTYLE

SPORT
TEJ E KETEJ
BLOG
EMISIONE